



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË

13.07.2026

REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË		RECEIVED	
Njësia Org. Org. Jerinica Org. Unit	Numri Ezroj Number	Shtesa Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	052	32064	Z

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis

Nr-DATË/A:	07Nr.418 datë 13.07.2026
PËR/TO:	Kryetarit të Komunës z.Bali Muharremaj Kuvendit të Komunës së Suharekës z.Bexhet Kuçi Bordin e drejtorëve
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis – Suharekë <i>Drejtori i drejtorisë:</i> Visar KUÇI - kordinator i ekipit komunal për monitorim dhe zbatim të PZhK-së dhe HZK-së <i>Zyrtare e lartë për ndërtimtari:</i> Doruntina Bytyqi- zëvën-dës kordinatore e ekipit komunal për monitorim dhe zbatim të PZhK-së dhe HZK-së
LËNDA/SUBJECT:	Raporti vjetor për monitorimin dhe zbatimin e PZHK-së dhe HZK-së: -për vitin 2023 -për vitin 2024 -për vitin 2025

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor neni 10 paragrafi 3, UA të MMPHI-Nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal neni 12 dhe 13, UA te MMPHI-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës neni 42 dhe 43, Vendimit 01-Nr-016-10590 datë 03.03.2026 për formimin e ekipit komunal për monitorimin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të Komunës së Suharekës dhe Vendimit 01-Nr-016-10591 datë 03.03.2026 për formimin e ekipit komunal për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Suharekës (HZK), autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhimin hapësinor (DUPM) është përgjegjës për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës në koordinim dhe bashkpunim me drejtoritë sektoriale brenda komunës.

Qëllimi i raportit për monitorimin e zbatimit të PZHK-së dhe HZK-së

Ky raport ka për qëllim paraqitjen e gjendjes së zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës, monitorimin e aktiviteteve të planifikuara, identifikimin e sfidave dhe ofrimin e rekomandimeve për përmirësim-plotësim të dokumenteve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky raport është hartuar duke u bazuar në Planin e Monitorimit (pjesë e dosjes së Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030) dhe në harmoni me kërkesat e UA të MMPHI-Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës përmes treguesve që matin realizimin e këtij plani dhe ndikimin e tij në zhvillimin e tërë territorit të komunës së Suharekës.

Përmes këtij monitorimi për zbatimin e HZK-së, do të ofrohet një përmbledhje lidhur me zhvillimin e komunës rreth aktiviteteve të planifikuara, për prezantimin e gjendjes aktuale si dhe për analizën e rezultateteve të arritura deri më tani.

Sqarim: Raporti i monitorimit për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Hartës Zonale të Komunës (HZK) nuk është hartuar në vitet e kaluara (2023 dhe 2024) për shkak të angazhimeve të mëdha sektoriale në proceset tjera të domosdoshme institucionale në fushën e planifikimit hapësinorë dhe urban, si dhe për shkak të kufizimeve në kapacitetet administrative dhe teknike për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave të nevojshme për monitorim.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe fokusi institucional ka qenë i mbingarkuar në përmbushjen e obligimeve ligjore dhe procedurale që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve, lëshimin e lejeve ndërtimore, hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit dhe kordinimin me institucionet e nivelit qendror.

Me qëllimin të përmbushjes së obligimeve ligjore, drejtoria ka ndërmarr masa shtesë për krijimin e një sistemi më të strukturuar të monitorimit, mbledhjes së të dhënave dhe raportimit periodik, në mënyrë që raportet e monitorimit të PZHK-së dhe HZK-së të hartohen dhe dorëzohen brenda afatave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PZHK-së dhe HZK-së SIPAS FUSHAVE SEKTORIALE

Metodat e aplikuara në përpilimin e Raportit monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të HZK-së janë të ndryshme dhe mbi të gjitha ato ndërlidhen në bashkëpunim me drejtorit komunale. Nga të gjitha sektorët janë siguruar informacione përmes takimeve punuese të ekipit komunal, analizës së projekteve dhe aktiviteteve të planifikuara dhe krahasimin e gjendjes aktuale me objektivat e PZHK-së, monitorimin e zbatimit të HZK përmes realizimit të planeve/projekteve të cilat janë prezantuar në vazhdim të këtij Raporti dhe në bazë të dhënave në arkivat e dy viteve paraprake dhe vlerësimit vetanak nga ana e zyrtarëve përgjegjës të Komunës lidhur me të arriturat në sektorët e tyre.

Mjetet e zhvilluara për hartimin e këtij raporti gjatë procesit janë bazuar në Planin e veprimit dhe monitorimit të HZK ku përfshijnë:

Kornizën për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara me planin e veprimit të HZK-së në kuadër të drejtorive sektoriale, analizën e procesit të shqyrtimit të kushteve ndërtimore sipas kërkesave dhe sllidat gjatë trajtimit të tyre në raport me kushtet e përcaktuara në HZK, vlerësimin e efekteve që kanë rezultuar nga zbatimi i atyre projekteve, aplikimi i kriterëve të përcaktuara për leje mjedisore komunale dhe niveli të realizimit të projekteve.

VLERËSIMI DHE REZULTATET E MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË PZHK-së DHE HZK-së

Gjatë vlerësimit dhe analizës së nivelit të zbatimit të hartës zonale të komunës është marrë për bazë zbatimi i dispozitave të HZK-së në procesin e planifikimit dhe zhvillimit, përputhshmëria e lejeve ndërtimore dhe vendimeve administrative me përcaktimet e HZK, dhe respektimi i destinimeve të parametrave urbanistike dhe kushteve të ndërtimit. Analizat e mësipërme janë paraqitur në vazhdimësin e këtij dokumenti në formë tabelare ku janë kalkuluar përqindjet e tokës ndërtimore të aprovuara me vendime nga DUPM në krahasim me tokën e planifikuar për zhvillim me HZK.

Zbatimi i Hartës Zonale të Komunës përbën një nga mekanizmat kryesor për orientimin dhe kontrollin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit. Përmes përcaktimit të destinimit të tokës, parametrave urbanistikë dhe kushteve të zhvillimit, HZK siguron që zhvillimi hapësinor të realizohet në mënyrë të planifikuar, të balancuar dhe në përputhje me interesin publik.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se zgjerimi i pakontrolluar urban ka shumë për të punuar. Gjatë periudhës së monitorimit është vlerësuar se HZK ka ndikuar në orientimin e zhvillimit drejt zonave të parapara për ndërtim duke kontribuar në shfrytëzimin më racional të tokës. Zbatimi i dispozitave të saj ka ndihmuar në ruajtjen e tokës bujqësore, mbrojtjen e hapësirave publike dhe zonave me vlera natyrore e mjedisore si dhe në krijimin e kushteve për një zhvillim më të organizuar të vendbanimeve.

Harta Zonale e Komunes njëkohësisht ka përmirësuar cilësinë e procesit të vendimmarrjes në fushën e planifikimit hapësinor, duke ofruar bazë të qartë për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimore dhe zhvillimore. Kjo ka rritur transparencën, sigurinë juridike dhe trajtimin e barabartë të të gjitha kërkesave në sektorin publik dhe privat.

Zbatimi i HZK-së nga aspekti i zhvillimit ekonomik ka krijuar kushte më të favorshme për investime, pasi zhvillimi i territorit bazohet në rregulla të qarta të planifikuara. Planifikimi i koordinuar i infrastrukturës rrugore, rrjeteve teknike, hapësirave publike dhe shërbimeve sociale ka mundësuar përdorim më efikas të investimeve publike në përmirësimin e cilësinë së jetesës së qytetarëve.

Monitorimi ka treguar gjithashtu se zhvillimi i qëndrueshëm kërkon monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të HZK-së, përditësim të të dhënave hapësinore dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet institucioneve përgjegjëse, me qëllim që plani të vazhdojë t'u përgjigjet nevojave reale të zhvillimit të komunës dhe ndryshimeve socio-ekonomike.

Procesi i monitorimit të zbatimit të Hartës Zonale të Komunës ka evidentuar edhe një sërë sfidash që ndikojnë në zbatimin efektiv të planit dhe në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.

Një ndër sfidat kryesore lidhet me rritjen e kërkesave për zhvillim në zona ku kufizimet e përcaktuara nga HZK-ja nuk lejojnë realizimin e ndërhyrjeve të parashtruara me kërkesa. Kjo gjë ka krijuar presion të vazhdueshëm gjatë zbatimit të planit për ndryshimin ose interpretimin e dispozitave planifikuese. Vonesat për sigurimin e mjeteve buxhetore është një nga sidat tjera me të cilat jemi ballafaquar për realizimin e projekteve. Procedurat e zgjatura të prokurimit si dhe ndryshimet e nevojshme në prioritet zhvillimore gjithashtu kane qenë penges.

Monitorimi ka treguar se legjislacioni i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit kërkojnë të jenë në harmonizim të vazhdueshëm me dokumentet planifikuese, në mënyrë që zbatimi i tyre të jetë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Zhvillimet e reja demografike, ekonomike dhe infrastrukturore si rezultat i zhvillimeve aktuale të pa planifikuara me HZK kanë krijuar nevojën për rishikimin ose plotësimin e zgjidhjeve planifikuese, bazuar në analiza profesionale dhe në interesin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Nga aspekti institucional, sfida mbetet siguri i kapaciteteve të mjaftueshme profesionale dhe teknike për monitorim sistematik, analizimin e treguesve të zhvillimit dhe përditësimin e vazhdueshëm të bazës së të dhënave hapësinore. Njëkohësisht, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve përgjegjëse dhe shkëmbimi i të dhënave duhet të forcohet për të mundësuar vendimmarrje më efikase dhe të bazuar në informacione të sakta.

Po ashtu, sfida mbetet kontrolli i zhvillimeve në terren dhe parandalimi i ndërhyrjeve që nuk janë në përputhje me përcaktimet e HZK-së. Kjo kërkon koordinim më të mirë ndërmjet organeve përgjegjëse për planifikim, ndërtim, inspektim dhe menaxhim të territorit.

Për tejkalimin e këtyre sfidave nga ana e ekipit monitorues është konstatuar, se është e nevojshme të vazhdohet monitorimi i rregullt i zbatimit të HZK-së në përputhje me dispozitatat ligjore, të përmirësohen kapacitetet institucionale si dhe të përditësohen të dhënat hapësinore.

Në raste kur monitorimi evidenton ndryshime të rëndësishme në zhvillimin e territorit, duhet të shqyrtohet nevoja për rishikimin e Hartës Zonale të Komunës në përputhje me procedurat ligjore.

1.Numri i lejeve ndërtimore dhe numri i certifikatave të shfrytëzimit të lëshuara sipas kategorisë së ndërtimit

Lëndët e proceduara për Leje të Ndërtimit						
Viti:	2023		2024		2025	
Leje Ndërtimore të lëshuara	65		33		30	
Çertifikatë Përdorimit:	Kategoria 1	51	Kategoria 1	9	Kategoria 1	21
	Kategoria 2	14	Kategoria 2	24	Kategoria 2	9
Gjithsej:	128					
Çertifikatë Përdorimit:	Kategoria 1	0	Kategoria 1	0	Kategoria 1	0
	Kategoria 2	2	Kategoria 2	0	Kategoria 2	1
Gjithsej:	3					
Pëlqim/Leje infrastrukturës:	7		7		9	
Gjithsej:	23					

Përqindjet e shfrytëzimit të tokës ndërtimore të aprovuara nga DUPM në raport me tokën e planifikuar sipas kategorizimit të HZK-së

Tabela e shfrytëzimit të tokës ndërtimore me lejet e lëshuara në raport me tokën e planifikuar me HZK për vitin kalendarak 2025							
Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i strukturës së ndërtuar	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqet për zhvillim (ha) sipas HZK	Sipërfaqet me lejet e lëshuara (ha)	% e shfrytëzimit të tokës	
1 Zb-1	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	611.95	0	0.00%	
2 Zb-2	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	2332.71	0.2	0.01%	
3 Zb-3	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Sub - Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi	248.85	1.88	0.76%	
4 Zb-4	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi	68.95	1.48	2.15%	
5 Zb-5	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi	37.94	1.24	3.27%	
6 Zb-6	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	3.43	0	0.00%	
7 Zb-7	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	79.4	0.34	0.43%	
8 Zb-8	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe Sub-Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	34.36	0	0.00%	
9 Zb-9	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	28.63	0.64	2.24%	
10 Zb-10	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	20.71	0	0.00%	
11 Zb-11	Zonë Komerciale			19.61	0	0.00%	
12 Zb-12	Zonë Komerciale			3.35	0	0.00%	
13 Zb-13	Zonë Komerciale			12.99	0	0.00%	
14 Zb-14	Zonë Komerciale			23.72	0	0.00%	
15 Zb-15	Zonë Komerciale			2	0	0.00%	
16 Zb-16	Zonë Industriale			255.78	0	0.00%	

17		Zonë Industriale			99.28	2.66	2.68%
18		Zonë Industriale			17.92	0	0.00%
19		Zonë rekreative-turistike	Sport dhe Rekreacion		26.85	0	0.00%
20		Zonë rekreative-turistike	Park/rekreim/gjelbrim		156.5	0	0.00%
21		Zonë rekreative-turistike	Hapësira/komplekse sportive		38.73	0	0.00%
22	Zkt-1	Rrugë			1019.92	0	0.00%
23	Zkt-2	Parking			1.67	0	0.00%
24	Zkt-3	Stacion i Autobusëve			0.5	0	0.00%
25	Zkt-4	Infrastrukturë e Transportit Ajrorë - Hipodrom			9.95	0	0.00%
26	Zb	Zonë bujqësore			16371.57	8.7	0.05%
27		Zona Pyjore			14577.68	0	0.00%
29		Zonë-minierë sipërfaqësore			114.26	0	0.00%
30		Sipërfaqe ujore			283.48	0	0.00%
31		Rezervat Natyror			14.36	0	0.00%
32	ZmH	Zonë e Mbrojtur Arkeologjike-Historike			26.38	0	0.00%
					36543.43	17.14	0.05%

Tabela e shfrytëzimit të tokës ndërtimore me lejet e lëshuara në raport me tokën e planifikuar me HZK për vitin kalendarik 2024

	Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i strukturës së ndërtuar	Lloji i ndërtesës	Sipërfaqet për zhvillim (ha) sipas HZK	Sipërfaqet me lejet e lëshuara (ha)	% e shfrytëzimit të tokës
1	Zb-1	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	611.95	0	0.00%
2	Zb-2	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	2332.71	0.18	0.01%
3	Zb-3	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Sub - Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi	248.85	1.36	0.55%
4	Zb-4	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi	68.95	1.64	2.38%
5	Zb-5	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi	37.94	4.14	10.91%
6	Zb-6	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	3.43		0.00%
7	Zb-7	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	79.4		0.00%
8	Zb-8	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe Sub-Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	34.36	0.15	0.44%
9	Zb-9	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	28.63	0.17	0.59%
10	Zb-10	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	20.71	0.3	1.45%
11	Zk-1	Zonë Komerciale			19.61		0.00%
12	Zk-2	Zonë Komerciale			3.35		0.00%
13	Zk-3	Zonë Komerciale			12.99		0.00%
14	Zk-4	Zonë Komerciale			23.72		0.00%
15	Zk-5	Zonë Komerciale			2		0.00%
16	Zi-1	Zonë Industriale			255.78	0.61	0.24%
17	Zi-2	Zonë Industriale			99.28		0.00%
18	Zi-3	Zonë Industriale			17.92		0.00%
19	Zr-1	Zonë rekreative-turistike	Sport dhe Rekreacion		26.85		0.00%

20		Zonë rekreative-turistike	Park/rekreim/gjelbrim		156.5	0	0.00%
21		Zonë rekreative-turistike	Hapësira/komplekse sportive		38.73	24.97	64.47%
21	Zkt-1	Rrugë			1019.92	0	0.00%
21	Zkt-2	Parking			1.67	0	0.00%
21	Zkt-3	Stacion i Autobusëve			0.5	0	0.00%
21	Zkt-4	Infrastrukturë e Transportit Ajrorë - Hipodrom			9.95	0	0.00%
21	Zb	Zonë bujqësore			16371.57	15.3	0.09%
21		Zonë Pyjore			14577.88	0	0.00%
21		Zonë-miniere sipërfaqësore			114.26	0	0.00%
21		Sipërfaqe ujore			283.48	0	0.00%
21		Rezervat Natyror			14.36	0	0.00%
21	Zmah	Zonë e Mbrojtur Arkeologjike-Historike			26.38	0	0.00%
					36543.43	48.82	0.13%

Tabela e shfrytëzimit të tokës ndërtimore me lejet e lëshuara në raport me tokën e planifikuar me HZK për vitin kalendarik 2023

	Kodi	Shfrytëzimi i tokës	Lloji i strukturës së ndërtuar	Lloji i ndërtësës	Sipërfaqet për zhvillim (ha) sipas HZK	Sipërfaqet me lejet e lëshuara (ha)	% e shfrytëzimit të tokës
1	Zb-1	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	611.95	0.4	0.07%
2	Zb-2	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi	2332.71	0.35	0.02%
3	Zb-3	Zonë e banimit me një njësi	Sipërfaqe Sub - Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi	248.83	1.31	0.53%
4	Zb-4	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi	68.95	0.92	1.33%
5	Zb-5	Zonë e banimit me shumë njësi	Sipërfaqe Urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi	37.94	0.18	0.47%
6	Zb-6	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	3.43	0	0.00%
7	Zb-7	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	79.4	0	0.00%
8	Zb-8	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe Sub-Urbane	Ndërtesa banimi me një njësi dhe afarizëm	34.36	0	0.00%
9	Zb-9	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane e përgjithshme	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	28.63	0.98	3.42%
10	Zb-10	Zonë për shfrytëzim të përzier	Sipërfaqe urbane qendrore	Ndërtesa banimi me shumë njësi dhe afarizëm	20.71	0.26	1.26%
11	Zk-1	Zonë Komerciale			19.61	0	0.00%
12	Zk-2	Zonë Komerciale			3.35	0	0.00%
13	Zk-3	Zonë Komerciale			12.99	0	0.00%
14	Zk-4	Zonë Komerciale			23.72	0	0.00%
15	Zk-5	Zonë Komerciale			2	0	0.00%
16	Zi-1	Zonë Industriale			253.78		0.00%
17	Zi-2	Zonë Industriale			99.28	3.59	3.62%
18	Zi-3	Zonë Industriale			17.92		0.00%
19	Zr-1	Zonë rekreative-turistike	Sport dhe Rekreacion		26.85	0.22	0.82%
20	Zr-2	Zonë rekreative-turistike	Park/rekreim/gjelbrim		156.5	0	0.00%

21		Zonë rekreative-turistike	Hapësira/komplekse sportive		38.73	0	0.00%
21	Zkt-1	Rrugë			1019.92	0	0.00%
21	Zkt-2	Parking			1.67	0	0.00%
21	Zkt-3	Stacion i Autobusëve			0.5	0	0.00%
21	Zkt-4	Infrastrukturë e Transportit Ajrorë - Hipodrom			9.95	0	0.00%
21	Zb	Zonë bujqësore			16371.57	0	0.00%
21	p	Zona Pyjore			14577.68	0	0.00%
21		Zonë-miniere sipërfaqësore			114.26	0	0.00%
21		Sipërfaqe ujore			283.48	0	0.00%
21		Rezervat Natyror			14.36	0	0.00%
21	ZmaH	Zonë e Mbrojtur Arkeologjike-Historike			26.38	0	0.00%
					36543.43	8.21	0.02%

Me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të transparencës edhe gjatë zbatimit të hartës zonale, për ndërtimin dhe fuqizimin e dinamikës së zbatimit të planit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis ka bërë publikimin në webfaqen e komunës të Vendimeve të Kushteve Ndërtimore, Lejeve Ndërtimore, Çertifikatave të Përdorimit dhe Vendimeve të ndryshme që lidhen me zbatimin e PZHK dhe HZK për mundësin e njoftimit të qytetarëve në lidhje me procesin e zbatimit transparent të këtyre dokumenteve.

DUPM ka realizuar digjitalizimi i PZHK dhe HZK me të cilën e ka lehtësuar edhe më shumë leximin në dokumenteve të planifikimit dhe ka ofruar mundësin e marrjes së informatave për destinimet e planifikuara si dhe qasje në përdorimin e sistemit të E-leja.

2. Statusi i mjedisit të rrezikuar

Ndër shkaktarët kryesor të rrezikimit të mjedisit janë: ujërat e zeza, degradimi i pyjeve, niveli i lartë i dioksidit të karbonit si pasojë e veprimtarisë së disa industrive të ndryshme, lirimi i gazrave nga qarkullimi i automjeteve, vendprodhimet e asfaltit, etj.

Lidhur me trajtimin e ujërave të zeza gjatë periudhës raportuese, Komuna ka përfunduar disa projekte në fushën e ndërtimit të kanalizimeve, por edhe më tutje mbetet shqetësuese mungesa e impiantëve për trajtimin e ujërave të zeza, të cilat projekte vlerësojmë se duhet zhvilluar në nivel kombëtar.

Komuna ka marrë masa për mbrojtje nga vërshimet, ku është bërë realizimi i projekteve për ndërtimin e dy kolektorëve të ujërave atmosferike në qytet dhe zgjerimin e shtratit të lumit Topllua në disa zona përmes së cilave rreziqet nga vërshimet në qytet janë zvogëluar në masë të konsiderueshme. Rreziku më i shtuar nga vërshimet është në disa fshatra ku kalon lumi Topllua, me qëllim evitimit të rrezikut nga vërshimet është bërë identifikimi i zonave kritike dhe Komuna ka planifikuar vazhdimin e rregullimit të shtratit të lumit në bashkpunimin me ministrinë përkatëse dhe në kordinim me komunat në të cilat kalon lumi Toplluha.

Sa i përket degradimit të pyjeve përgjegjësi themelore tani është jashtë autoriteteve komunale. Megjithatë, Komuna është duke e intensifikuar angazhimin në fuqizimin e kontrolleve në kuadër të përgjegjësi të saja.

Në kuadër të mbrojtjes mjedisore, komuna ka mundur kushtet për zhvillimin e disa projekteve të energjisë efikiente dhe ka realizuar disa projekte në ndërtesat shkollore.

Ndërtimet e ndërtesave të kategorisë së II-të janë të ndërlidhura edhe me çështjet specifike mjedisore, të cilat janë nën përgjegjësinë e autoriteteve kompetente të Komunës.

Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim sektori i Mjedisit iu është bashkangjitur në gjysmën e dytë të vitit 2023 sipas vendimit nga zyra e Kryetarit për emërtimin e drejtorive përkatëse, sektor ky që deri me datë 08.08.2023 ishte në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë. Për periudhën Janar-Djetor 2023 lëndet e shqyrtuara janë të paraqitura në tabel.

Lejet Mjedisore Komunale

2023	2024	2025
13	20	15

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore janë marrë për bazë elementet themelore të ndikimeve në mjedis, si në: në tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerim të mbeturinave, zhurma, procesi teknologjik i punës, masat në raste të aksidenteve, masat për rehabilitimin e sipërfaqës gjelbëruese, sipërfaqja e gjelbërt, mbjellja dhe lokacionet e drunjëve etj.

Me qëllim të rritjes së nivelit të mbrojtjes të mjedisit janë zhvilluar disa aktivitete vëdiqësuese mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror me hisedarët kryesorë për trajtimin e sfidave që lidhen me menaxhimin e pellgjeve lumore me qëllim të identifikimit të problematikave dhe diskutimin e masave për përmirësimin e menaxhimit të burimeve ujore dhe territorin e komunës.

Gjatë javës së Tokës, përkatësisht mbrojtjes së mjedisit kemi zhvilluar aktivitetin e pastrimit të mbeturinave në të gjithë territorin e Komunës së Suharekës.

3.Shkalla e prodhimitarisë

Vlerësimi i shkallës së prodhimitarise lidhet me ndikimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës në ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin racional të potencialeve prodhuese të tërë territorit të komunës sonë. Përmes monitorimit është vlerësuar nëse destinimi i tokës është respektuar në përputhje me përcaktimet e HZK dhe nëse zhvillimet e realizuara kanë ndikuar pozitivisht në funksionimin e aktiviteteve bujqësore ekonomike dhe industriale.

Harta Zonale e Komunes se Suharekes ka kontribuar në mbrojtjen e tokës bujqësore, duke ndihmuar në ruajtjen e kapaciteteve prodhuese dhe në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Gjithashtu përcaktimi i zonave të dedikuara për veprimtari ekonomike dhe prodhuese ka krijuar bazë të endrueshme për zhvillim të investimeve, zgjerimin e aktiviteteve afariste dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Për ta pasur zhvillime me te mira prodhuese në të ardhmen, nga ekipi monitorues eshte rekomanduar mbrojtja e vazhdueshme e tokës me potencial të lartë prodhues, zhvillimi i zonave ekonomike sipas planifikimit hapësinorë, përmirësimi i infrastrukturës teknike dhe krijimi i kushteve që nxisin njëkohësisht balancën ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe interest publik.

4.Shkalla e ngritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe sociale

Komuna ka vazhduar të investojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike dhe sociale, me qëllim rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore. Investimet në infrastrukturën publike, përfshirë rehabilitimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e ndriçimit public, ndërtimin e vendprirjeve të autobusëve me kabina dhe ndriçim si dhe realizimin e projekteve të tjera komunale, kanë ndikuar në rritjen e sigurisë, qasjes dhe funksionalitetit të shërbimeve publike.

Përmirësimi i infrastrukturës dhe planifikimi i zhvillimit hapësinor përmes zbatimit të Hartës Zonale ka krijuar kushte më të favorshme për ofrimin e shërbimeve sociale, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe rekreative. Këto investime kane kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës, rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe krijimin e një mjedisi funksional, gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm për zhvillim ekonomik e shoqëror.

Komuna ka shënuar progres të konsiderueshëm në ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe sociale përmes investimeve në infrastrukturën arsimore, shëndetësore dhe sociale. Janë realizuar projekte për ndërtimin dhe zgjerimin e objekteve shkollore, sallave sportive, kulturore, çerdheve për fëmijë, ambulancave të mjekësisë familjare si dhe objektet e zjarrfikasave në qytet dhe në vendbanimet rurale. Këto investime kanë përmirësuar qasjen e qytetarëve në shërbimet bazë, duke krijuar kushte më të mira për arsimim, zhvillim të aktiviteteve sportive dhe ofrim të shërbimeve shëndetësore, me ndikim drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës së banorëve. Vlene te ceket se ne bashkëpunim me donatorët është ndërtuar një qendër e specializuar për fëmijët me autizëm dhe objekti i ri i Hendikosit, duke zgjeruar shërbimet sociale dhe duke promovuar përfshirjen sociale të këtyre kategorive. Ky investim paraqet një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një sistemi më gjithëpërfshirës të shërbimeve publike dhe garantimit të qasjes së barabartë në shërbime për të gjithë qytetarët. Këto investime janë në përputhje me objektivat e

Hartës Zonale të Komunës dhe kanë kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, duke siguruar shpërndarje më të balancuar të shërbimeve publike ndërmjet zonave urbane dhe rurale, si dhe duke rritur cilësinë jetesore dhe zhvillimore.

5.Shkalla e ngirtjes së cilësisë dhe shërbimeve transportuese dhe teknike

Shkalla e ngirtjes së cilësisë së shërbimeve transportuese dhe teknike është vlerësuar në baze të investimeve të realizuara dhe aktiviteteve të ndermarra nga sektori përgjegjës për përmirësimin e infrastruktures publike. Pas aprovimit të Hartës Zonale Komuna kanë vazhduar investimet në ndërtimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellesit dhe kanalizimit, përmirësimin e ndriqimit publik, si dhe zgjerimin e rrjeteve tjera teknike. Këto investime kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, duke krijuar kushte të favorshme për zhvillim urban dhe ekonomik.

Gjatë periudhës raportuese, komuna ka ndermarre investime konkrete për ngirtjen e cilësisë së shërbimeve transportuese dhe teknike, përmes ndërtimit dhe funksionizimit të nenstacioneve të autobusëve (vendprirjeve) të pajisura me kabina mbrojtëse -digjitalë dhe ndriqim publik. Realizimi i këtyre projekteve ka përmirësuar kushtet e pritjes për udhëtarët, ka rritur sigurinë dhe qasjen në transportin publik, veqanërisht gjatë orëve të mbremjes dhe në kushte të pafavorshme atmosferike. Këto investime kontribojnë në modernizimin e infrastruktures transportuese, rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin e mobilitetit të qytetarëve në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të PZHK-së dhe HZK-së,

6. Përqindja e investimeve kapitale publike dhe private për vitin përkatës si ndërtimin e infrastrukturës teknike, sociale dhe publike

Plani i monitorimit 2023

Prioritetet strategjike për zhvillimin e ekonomisë PS - ZHE 1 Prodhim i energjisë së ripërtëritshme									
Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Treguesit e zbatimit të aktivitetit	Treguesit e zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet e zbatimit të projektit	Përgjegjësi për monitorimin të zbatimit	
1 Nderimi i mullinjve të erës për prodhim energjetik në Dudakovë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	IP		
2 Nderimi i mullinjve të erës për prodhim energjetik në Duhel	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	IP		
3 Nderimi i hidrocentralit pranë liqenit të Dragajës	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	IP		
PS - ZHE 2 Ngritja e prodhimtarisë bujqësore									
1 Nderimi i infrastrukturës rrugore -fushore për bujqësi në Komunë	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Ky projekt ka përfunduar me sukses.	DBZ/HRP		
2 Përkrahje për ngritje të serrave	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Është realizuar me sukses	DBZ/HRP		
3 Furnizimi me material fidanor Hardhi rrushi –Kumbullës-Atje-1 gjithi	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP		
4 Furnizimi i fermerëve me Moto kultivator	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Ky projekt është realizuar shumë të mirë	DBZ/HRP		

5	Rregullimi dhe ndërtimi i stallave për bageti	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP
7	Projektet zhvillimore për përpunimin e produkteve bujqësore	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP
8	Projektet zhvillimore për Hortikulturë:	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP MBPZHR
9	Projektet zhvillimore për Bledari, sheqerlari, peskikatori	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP MBPZHR
10	Projektet zhvillimore për Turizëm Rural	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBZ/HRP MBPZHR
PS - ZhE 3 Ngritja e prodhimtarisë përpunuese në Agro-zonë dhe Zonë Industriale								
1	Hartimi i Planit Rregullues të Hollësisë për parkun e biznesit/ industrial	Po	Po	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Komuna i ka iniciuar procedurat përmasas mbledhje	DUP
2	Ndërtimi i kolektorit për trajtimin e ujërave industrial në Agro - Zonë	Jo	Jo	0.0%	0.0%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Mungesë të mjeteve buxhetore	DSHPME
3	Lirimi nga taksat komunale për ndërtuesit që shfrytëzojnë për prodhimtari përpunuese	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DUP- DBEF
PS - ZhE 4 Shfrytëzimi i potencialëve natyrorë për zhvillim të turizmit								
1	Hartimi i Planit Rregullues të Hollësisë të fshatit rekreativ-turistik në Delloç	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vëzhgësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DBEF

Prioritetet strategjike për përmirësimin e infrastrukturës teknike
PS - IT1 - Ngritja e kapaciteteve furnizuese të burimeve ujore

Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit	Përfshirja e BVM	Treguesit e monitorimit të zbatimit	Shkalla e zbatimit	Treguesit e zbatimit	Vlerësimet e projektit	Përfundimet e monitorimit të zbatimit
1. Ndërtimi i akumulacionit ujor në Dragaçinë me kapacitet të vëllimit ujor prej 6.8 milion m ³	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E. dobët 2. E. mirë 3. Shumë e mirë	Munges e fondeve	MMPHI/ MZHE
2. Ngritja e kapacitetit të rezervuarit shtesë me stacioni të pompimit me 500m ³ në Biraq (38-0)	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	4. E. dobët 5. E. mirë 6. Shumë e mirë	Munges e fondeve	MMPHI/ MZHE
3. Eliminimi i gypit magjstral ACC Ø 300mm, dhe zëvendësimi i tij me gyp të materialit HDPE PE 100, si dhe vendosja e rrjetit sekondar përgjatë rrugës magjistrale Suharekë-Prizren (deri te stacioni i Pompave në Malësi të re).	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	7. E. dobët 8. E. mirë 9. Shumë e mirë	Munges e fondeve	MMPHI/ MZHE/HRJ
4. Vendosja e rezervuarit të ri mbi rrugën magjistrale Suharekë-Rahovec në Studenqan me kapacitet 750 m ³ , rrjetja e kapacitetit të pompave dhe kështu me rrjetin ekzistues (984-0)	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	10. E. dobët 11. E. mirë 12. Shumë e mirë	Munges e fondeve	MMPHI/ MZHE/HRJ
5. Ilapja e puseve të reja-ndërtimi i stacionit të pompave të "Pusi i Arit" dhe ndërtimi i rezervuarit të ri 1500m ³ në malësi të Greqkocit në lartësi prej 600m	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	13. E. dobët 14. E. mirë 15. Shumë e mirë	Munges e fondeve	MMPHI/ MZHE/HRJ
6. Holumtimi i burimit të ujit për fshatin Reçan (5-8 l/s)	Jo	Jo	100%	100%	1. Shumë e mirë	Ky projekt është realizuar shumë të mirë	MZHE/HRJ
7. Holumtimi i burimit të ujit për fshatin Nishor (6-8 l/s)	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E. dobët 2. E. mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vështirësive, vërtetjave dhe sugjerimeve	MZHE/HRJ
8. Relativiteti i drenazheve, kapazimeve dhe zëvendësimi i gypit prej burimit deri te rezervuarit kryesor në fshatin Greqkoc	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E. dobët 2. E. mirë 3. Shumë e mirë	Përkrahimi i vështirësive, vërtetjave dhe sugjerimeve	MZHE/HRJ

9	Kapitimi i burimit të ujit, ndërtimi i kaptafiave, ndërtimi i rezervuarit 500 m ³ dhe vendosja e gypit nga burimi deri në rezervuar në fshatin Budakovë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkirimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	MZHE/HRJ
PS - IT2 Ngritja e kapaciteteve furnizuese të rrjetit të ujësjellësit								
1	Rritja e kapaciteteve të buirneve të ujit në Samadrexhtë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Mungesë e mjeteve buxhetore	DSTIPME
2	Vendosja e gypit furnizues nga kaptafzha deri në hyrje të fshatit. Sotijë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkirimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	HRJ
3	Vendosja e gypit furnizues nga rezervuari në fshat deri në fshatin Gjimoc	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkirimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	HRJ
4	Vendosja e gypit furnizues nga rezervuari kryesor i fshatit Mushisht deri te rezervuari i ri (te shama e re)	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Nuk është funksional pasi që banorët nuk kanë lejuar të kyoqet	HRJ
5	Rritja e kapaciteteve të pompave për fshatin Reshtan	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Ky projekt është realizuar shumë të mirë	HRJ
6	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatin Nishor	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Mungesa e fondeve	HRJ
7	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Bllacë para fuqjes nën menaxhimin e Kompanisë	Po	Po	40%	40 %	E mirë	Nuk ka vështirësi në realizimin e projektit	HRJ
8	Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Sllapuzhan para fuqjes nën menaxhimin e Kompanisë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	4. E dobët 5. E mirë 6. Shumë e mirë	Mungesa e fondeve	HRJ
9	Ndërtimet e Ujësijellësit & Kanalizimit në vendbanime përmes projekteve me bashkëfinancim Komune-Banorë, Komune-Donatorë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përkirimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	HRJ

10	Ndërtimi i Ujësjellsve të ri, për fshatin Bazeqe	Po	Po	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Nuk është funksional pasi që baterit nuk kanë lejuar të kyoqet	HRJ
11	Sanimet dhe rregullimet e ujësjellsve	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përfshirimi i veshësive, vërëjtjeve dhe sugjerimeve	HRJ
12	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellsit për fshatin Stravuçin	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përfshirimi i veshësive, vërëjtjeve dhe sugjerimeve	HRJ
13	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellsit për fshatin Budakove, Buzhial, Krushice dhe Papaz	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Përfshirimi i veshësive, vërëjtjeve dhe sugjerimeve	HRJ
4	Ndërtimi i kanalizimit në lagjen Kabashli Mohlan	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Është ndërtuar para vitit 2025	DSHPME
Prioritetet strategjike për përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe transportit publik								
PS - IT1 - Përmirësimi i qarkullimit dhe sigurisë të trafikut								
	Aktivitetet e parapara	Përkirimi i aktivitetit të KAB	Përkirimi i aktivitetit të BYK	Treguesit e zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Treguesit e zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet e zbatimit të projektit	Përkirimi i zbatimit të zbatimit
1	Zbatimi i planit të veprimtari të Planit të Mobilitetit	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë		DUP - DSHPME
PS - IT2 - Përmirësimi i transportit publik								
1	Ndërtimi i 12 pikave pritëse në vend-ndaljet për autobusë të transportit publik në zonë urbane	Po	Po	100 %	100%	Shumë e mirë		DUP - DSHPME
PS - IT3 - Zgjerimi i rrjetit rrugor								
1	Zgjerimi i stacionit regional të autobusëve dhe parkingut publik nëntokësor	JO	JO	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ... %	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Është investuar dhe kontinua ka planifikuar buget për vitin 2026	DSHPME

2	Ndërtimi i rrugës së re Mashisht (L. Baqevc) - Sallgrazhde - Grekoc	Po	Po	100 %	100%	Shumë e mirë	Projekt me bashkëfinancim në mes MIMPIT dhe Komunes	DSHPME
3	Ndërtimi i rrugës së re Grekoc - Kortshe	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Projekt me bashkëfinancim në mes Ministrisë dhe Komunes	DSHPME
4	Ndërtimi i rrugës së re Bukosh - Budakovë	Po	Po	50%	50%	Shumë e mirë	Rrugë fushore	DSHPME DBZHRP
5	Ndërtimi i rrugës së re Maçkëve - Vranitq	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Mungesë e mjeteve buxhetore	DSHPME
6	Ndërtimi i rrugës së re Peqan - Bllacë	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Mungesë e mjeteve buxhetore	DSHPME
7	Ndërtimi i rrugës së re Studençan - Terzije	Po	Po	100 %	100%	Shumë e mirë		DSHPME
8	Ndërtimi i rrugës së re Samadrexhë - Njerebisht	Po	Po	100%	100 %	Shumë e mirë	E-shitë realizuar gjatë vitit 2023-2024	DSHPME
9	Ndërtimi i rrugës së re Dubrave - Savrovë	Po	Po	100 %	100%	Shumë e mirë	Projekt me bashkëfinancim me grant të performancës	DSHPME 2025
10	Ndërtimi dhe meremetimi i trotuareve dhe parkimeve në komunë	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Të realizuara gjatë vitit 2024-2025	DSHPME
Prioritetet strategjike për përmirësimin e infrastrukturës publike PS - IP1 Përmirësimi i infrastrukturës asfimentore								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit të KAB	Përfshirja e aktivitetit të BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Treguesit cilësorë të zbatimit të aktivitetit	Vlerësime të zbatimit të projektit	Përgjigjëse për monitorimin të zbatimit
1	Ndërtimi i objektit të SHFMU "Dhuria" në Samadrexhë (934-0)	Po	Po	Projekti është përfunduar dhe realizuar në masën 100% të planit të paraparë. Të gjitha aktivitetet dhe objektivat e	Projekti është zbatuar në masën 100%. Aktivitetet kryesore janë realizuar, ndërsa kanë mbetur vetëm punët përfundimtare për përmbylljen e plotë të projektit	Shumë e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes	DKA

					përcaktuara janë përbushur me sukses					
2	Ndërtimi i objekteve të SHFMU "Shkëndija" në Reqan (779-0)	Jo	Jo	Jo	Projekti ende nuk ka filluar të zbatohet dhe realizimi i tij është në masën 0% të planit të parapare. Aktivitetet e planifikuara pritet të fillojnë sipas afatit të përcaktuar	Sa përqind e projektit 1. E dobet është zbatuar? 0	4. Shuma e mirë	Projekti nuk ka filluar. Rekomandohet sigurimi i kushteve për fillimin e zbatimit.	DKA	
3	Ndërtimi i fushës sportive SHFMU "H. Ndreca" Maqitëve (288)	Po	Po	Po	Projekti është realizuar në masën 100%. Aktivitetet e planifikuara janë përfunduar plotësisht dhe objektivat e projektit janë arritur sipas planifikimit	Aktivitetet kryesore janë realizuar, ndërsa kanë mbetur vetëm punët përfundimtare për përmbylljen e plotë të projektit	4. Shuma e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes.	DKA	
4	Rregullimi i terreneve sportive dhe atletikes SHMP "Abdi Kamaj" Shirokë	Jo	Jo	Jo	Gjatë monitorimit është konstatuar se aktiviteti i planifikuar nuk ka filluar ende dhe nuk janë realizuar punime apo veprime konkrete në kuadër të projektit.	Sa përqind e projektit 1. E dobet është zbatuar? 0%	1. E dobet	Projekti nuk ka filluar. Rekomandohet sigurimi i kushteve për fillimin e zbatimit.	DKA	
5	Ndërtimi i fushës sportive në SHFMU "Dëshmoret e Kombit" Popollan (276)	Jo	Jo	Jo	Per realizimin e tij kerkohet ndërmarrja e veprimeve per gatitore, sigurimi i burimeve te nevojshme dhe krijimi i kushteve	Sa përqind e projektit 1. E dobet është zbatuar? 0	1. E dobet	Projekti nuk ka filluar. Rekomandohet sigurimi i kushteve për fillimin e zbatimit.	DKA	

					per fillimin e zbatimit sipas planifikimit.	Sa përqind e projektit është zbatuar? 100	4. Shumë e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes.	DKA
6	Ndërtimi i sallës sportive në SHMT- "Skender Luarasi" Suharekë (530)	Po	Po		Projekti është realizuar në masën 100%. Të gjitha aktivitetet e planifikuara janë përfunduar dhe objektivat e projektit janë arritur plotësisht.	Sa përqind e projektit është zbatuar? 100	Shumë e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes. <td>DKA</td>	DKA
7	Ndërtimi i sallës sportive në Greqoc (894-2)	Po	Po		Projekti është realizuar në masën 100%. Gjatë monitorimit është vlerësuar se aktivitetet e parapara janë përfunduar tërësisht dhe projekti është realizuar sipas planifikimit të përcaktuar	Sa përqind e projektit është zbatuar? 100	Shumë e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes. <td>DKA</td>	DKA
8	Ndërtimi i sallës sportive në Sallagrazhdë pranë "Gj. K. Skenderbeu" (63-0)	Po	Po		Projekti është realizuar në masën 100%. Të gjitha aktivitetet e planifikuara janë përfunduar dhe objektivat e projektit janë realizuar plotësisht	Sa përqind e projektit është zbatuar? 100	Shumë e mirë	Projekti është realizuar sipas planifikimit. Nuk janë evidentuar pengesa të rëndësishme. Rekomandohet monitorimi i mirëmbajtjes. <td>DKA</td>	DKA
PS - IP1 Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore									
1	Ndërtimi i qendrës së re kryesore të mjekësisë familjare në zonën urbane të Suharekës dhe shërbimin e QKMF ekzistues në QMF (124-0)	Jo	Jo		0.0%	0.0%	2. E dobët	Mungesa e fondeve	DShMS
2	Ndërtimi i QMF në Vrinëq (214-0)	Jo	Jo		0.0%	0.0%	3. E dobët	nuk plotësohen kriteret e parapara sipas ligjeve të parapara në fuqi (migrimi i popullsisë,	DShMS

										afërsia e fshatrave Bukoshi dhe Vraniq ku ndodhet QMF- Bukoshi	
3	Ndërtimi i AMF në Reshtan (285-0)	Jo	Jo	0.0%	0.0%	0.0%	4. E dobët	nuk plotësohen kriteret e parapara sipas ligjeve të parapara në fuqi (afërsia me Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare)	DSHMS		
PS - IFJ Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve sociale											
1	Ndërtimi i qendres për punë sociale në Suharekë (142-0)	Po	Po	100%	100%	100%	1. Shumë e mirë	E ndërtuar para aprovimit të hartës Zonale	DSHMS		
2	Ndërtimi i banesës në buzë të Programit të veçantë të huatimit, Suharekë (268-32)	Jo	Jo	0.0%	0.0%	0.0%	5. E dobët	komuna ka investuar 5.1 milion euro në ndërtimin e shtëpive sociale individuale, ku komuna ka participuar përafërsisht me 450.000 euro	DSHMS		
Prioritetet strategjike për përmirësimin e infrastrukturës sociale											
PS – IS1 Përmirësimi i infrastrukturës rekreative											
	Aktivitetet e parapara	Përkshirja e aktivitetit në KAB	Përkshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Tregues cilësi së zbatimit	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përgjegjëse për monitorim		
1	Ndërtimi i Fushës së futbollit në Grejkoc	Po	Po	100%	100%	100%	Shumë e mirë	U realizua në vitin 2024	DKRSM - MKRS		
2	Ndërtimi i Fushës së futbollit në Gjinoc	Po	Po	100%	100%	100%	Shumë e mirë	U përfundu në vitin 2023	DKRSM - MKRS		
3	Ndërtimi i Fushës së futbollit në Savrnë	Po	Po	100%	100%	100%	E mirë	Është realizuar	DKRSM - MKRS		

4	Ndërtimi i minifushave rekreative sportive në fagle të gjetit	po	po	100%	100%	Shumë mirë	Jane realizuar me grant te performances	DKRSM
5	Ndërtimi i terreneve sportive per MotoCross dhe Çiklizëm	po	po	100%	100%	E Mirë	Projekti i realizuar permes ojq automatorësh motocross Therandi	DKRSM
PS – IS2 Përmirësimi i infrastrukturës kulturore								
1	Mbrojtja dhe Konservimi i Kalasë në Kastere (2021)	po	po	100%	100%	Shumë e mirë	Punimet realizohen nga MKRS dhe Instituti për mbrojtjen e monumenteve të Prishtinës	DKRSM-MKRS
2	Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Mushisht (2021)	po	po	100%	100%	Shumë e mirë	Shtëpia e Kulturës është ndërtuar e re me ka pasur renovim në objektin e vjetër	DKRSM
3	Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Samadraqe	po	po	100%	100%	Shumë e mirë	Fshatë renovuar	DKRSM
4	Krijimi i rrjetit të organizatave kulturore	po	po	100%	100%	Shumë e mirë	Aktivitetet e Edukimit Jo formal mbështeten përmes Subvencioneve	DKRSM
5	Shënjimi i lokacioneve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore	po	po	100%	100%	Shumë e mirë	Eshtë realizuar permes ojq ne komune dhe tek muzeu i edukimit	DKRSM
PS – IS2 Përmirësimi i infrastrukturës rinore								
1	Ndërtimi i qendrave rinore në fshatrat Mushisht, Dubel, Studenqan (2024)	po	po	80%	80%	E mirë	Jane realizuar ne vitet paraqake	DKRSM-MKRS

2	Themelimi i fondit për edukim joformale	Po	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Aktivitetet e Edukimit Jo formal mbështeten përmes Subvencioneve	DKRSM
PS - IS3 Përmirësimi i infrastrukturës së vjetërave								
1	Ndërtimi i vjetërave të besimit mysliman në Sullugrahde	PO	Po	100%	100%	Shumë e mirë	Nuk ka pas probleme në realizimin e projektit	Komuna/ko moniteti
Prioritetet strategjike për mbrojtjen e mjedisit								
PS - MM1 Parandalimi i fatkeqësive natyrore								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Treguesit e zbatimit të cilësive të zbatimit të	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përqendreset për monitorimin e zbatimit
1	Ndërtimi i shtruar të lamit në Sopiç	PO	PO	100%	100%	Shumë e mirë	Punë vitit 2025 është bërë pastrimi i lamit	DSHPMB
PS - MM3 Parandalimi i degradimit të mjedisit								
1	Trajtimi i depozive ilegale	Po	Po	100%	100%	1. Shumë e mirë	Përkrahimi i vështirësive, vërejtjeve dhe sugjerimeve	DPU
PS - MM4 Përmirësimi i mjedisit urban								
1	Përmirësimi i hapësirave publike	Po	Po	100%	100%	1. Shumë e mirë	Jam realizuar gjatë vitit 2023	DPU
2	Renovimi i objekteve publike dhe kolektive të banimit	Po	Po	100%	100%	1. E mirë	Kontrakti ka qene 2 vjeçar2024/2025	DPU
Prioritetet strategjike për banim								
PS - B1 Përmirësimi i pamjeve të ndodhësive kolektive dhe publike								
	Aktivitetet e parapara	Përfshirja e aktivitetit në KAB	Përfshirja e aktivitetit në BVK	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Shkalla e zbatimit të aktivitetit	Treguesit e zbatimit të cilësive të zbatimit të	Vlerësimet mbi zbatimin e projektit	Përqendreset për monitorimin e zbatimit

1	Ndërtimi i Objektit të Zjarrfikësve	Po	Po	50%	50%	Shumë e mirë	Projekt dyvjeçar	Hashtfinansim me shfaqjen Jetëtimat e Balkanit/komunit
Prioritetet strategjike për vendbanimet informale								
PS- ShQTI Përgatitja e dokumenteve të planifikimit hapësior								
	Aktivitetet e parapara							
1	Hartimi i Planit Rregullues të Hollesishëm “Zona Qendër”	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Shkalla e zbatimit të projektit është zbatuar? ...%	Treguesit e monitorimit të zbatimit të aktivitetit	Vlerësimet e zbatimit të projektit	Përfundim i monitorimit të zbatimit të projektit DUP
2	Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Rregullues të Hollesishëm të Zonës Ekonomike për rrugës regionale Suharekë –Prizren	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	Sa përqind e projektit është realizuar ?	Përkrahimi i vlerësimeve dhe sugjerimeve	DUP
3	Hartimi i Planeve Rregulluese të Hollesishme për Zonën Ekonomike në Duhel	Po	Po	80%	80%	Shumë e mirë	Ka përfunduar hartimi i dafit të projektit	DUP
4	Përgatitja e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planeve Rregulluese të Hollesishme për Zonën Ekonomike në Duhel	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	Sa përqind e projektit është realizuar ?	Komuna ka të hartuar VSM për hartën zonale e cila vlen edhe për planin rregullues	DUP
5	Hartimi i Planit Rregullues të Hollesishëm të Zonës Ekonomike për rrugës regionale Suharekë-Prizren	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	Sa përqind e projektit është realizuar ?	Përkrahimi i vlerësimeve dhe sugjerimeve.	DUP

6	Pergatija e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Rregullues të Hotesishëm të Zonës Ekonomike	Jo	Jo	Sa % e projektit është realizuar ?	Sa përqind e projektit është zbatuar? ...%	1. E dobët 2. E mirë 3. Shumë e mirë	Komuna ka të harruar VSM për hartën zonale e cila vlen edhe për planin rregullues	DUP
---	--	----	----	------------------------------------	--	--	---	-----

Përqindja e projekteve të realizuara në përputhje me Hartën Zonale e Komunës është llogaritur duke krahasuar numrin e projekteve të realizuara pas aprovimit të këtij dokumenti me numrin e përgjithshëm të projekteve të planifikuara me Hartën Zonale të Komunës.

Planifikimi i projekteve me HZK dhe realizimi i tyre nuk përkufizohet vetëm me investime kapitale të përfunduara, pasi që zbatimi i HZK-së përfshijnë një gamë më të gjerë aktivitetesh që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Përveç realizimit të projekteve infrastrukturore, zbatimi i HZK-së reflektohet edhe në procesin e lëshimit të lejeve ndërtimore në përputhje me destinimin e përcaktuar të hapësirës, mbrojtjen dhe ruajtjen e tokës bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, kontrollin e zhvillimit urban, si dhe krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik dhe social. Investimet në infrastrukturën rrugore, sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, objektet arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, sociale dhe administrative, si dhe përmirësimi i rrjetit transportues dhe hapësirave publike, përbëjnë tregues të rëndësishëm të zbatimit të objektivave të HZK-së. Këto investime ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve, zhvillimin e balancuar të territorit dhe shfrytëzimin racional të tokës. Prandaj, vlerësimi i realizimit të HZK-së përpos në përqindjen e projekteve të realizuara është bazuar edhe në arritjen e objektivave strategjike të planifikimit hapësinor, respektimin e dispozitave të HZK-së gjatë zhvillimit të territorit dhe ndikimin e masave të ndërmarra në zhvillimin e përgjithshëm të komunës.

Nga 209 projekte të planifikuara për zbatim me HZK (2023/2024/2025) janë realizuar gjithsejt 96 projekte apo 45.93% e planifikimit.

2023- nga 60 projekte të planifikuara janë realizuar 25 apo 41.6%

2024-nga 69 projekte të planifikuara, janë realizuar 28 apo 40%

2025-nga 80 projekte të planifikuara janë realizuar 43 apo 53%

7.Shkalla e investimeve private të mëdha të planifikuara

Shkalla e investimeve private të mëdha të planifikuara është vlerësuar në bazë të projekteve të propozuara dhe kërkesave të paraqitura për zhvillim gjatë periudhës raportuese. Është vërejtur interesim i vazhdueshëm i investitorëve për zhvillimin e objekteve me karakter banimi, afarist dhe prodhues në përputhje me planifikimet e Hartës Zonale të Komunës.

Komuna ka marrë hapa konkrete për krijimin e kushteve të favorshme për tërheqjen e investimeve të mëdha, përmes fillimit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Ekonomike Duhël dhe Zonës Industriale Shirokë, dhe Planit Rregullues të Hollësishëm fshatit turistik Delloc. Hartimi i këtyre planeve paraqet një instrument të rëndësishëm për orientimin dhe menaxhimin e zhvillimit hapësinor, duke krijuar siguri juridike dhe planifikuese për investitorët potenciale.

Përcaktimi i destinimit të tokës, rregullimi i parametrave urbanistik, planifikimi i infrastrukturës rrugore, energjetike, të ujësjellësit dhe trajtimin e ujërave industriale si dhe definimi i kushteve të ndërtimit do të mundsojë zhvillimin e projekteve me vlerë të lartë investuese, kjo pritet të rrisë atraktivitetin e komunës për investitorët vendor dhe të huaj,

të nxis zhvillimin e sektorëve industriale, prodhues, logjistikë, tregtar dhe turistik si dhe të ndikoj në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e aktivitetit ekonomik dhe të hyrave komunale.

Në veqanti Planit Rregullues i Hollësishëm i Zonës Ekonomike Duhël dhe Zonës Industriale Shirokë krijon bazën për vendosjen e bizneseve prodhuese, ndërsa hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm fshatit turistik Delloc synon zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, promovimin e potencialeve natyrore dhe kulturore të komunës, si dhe tërheqjen e investimeve në sektorin e turizmit dhe hotelerisë. Këto iniciativa përbëjnë një bazë të zhvillimit afatgjatë ekonomik dhe hapësinorë të Komunës së Suharekës në përputhje e objektivat e Hartës Zonale të Komunës.

8. Anketimet e familjeve bujqësore

Anketimi i familjeve bujqësore nuk është realizuar për periudhën raportuese për shkak të kapaciteteve të kufizuara të stafit në kuader të drejtorisë së bujqësisë dhe ngarkesës së madhe në detyra prioritare në fushën e menaxhimit të tokës bujqësore dhe procedurave administrative. Megjithatë me qëllim të sigurimit të një baze me të besueshme të të dhënave, janë shfrytëzuar informacionet e disponueshme në sistemin e administrimit dhe shpërndarjes së subvencioneve bujqësore ku të dhënat janë deklaruar drejtperdrejt nga vet fermeret gjatë proceseve të aplikimit. Këto të dhëna paraqesin gjendjen e aktiviteteve bujqësore duke pasqyruar që ato perditesohen periodikisht nga përfituesit.

Komuna e Suharekës disponon rreth 21,500 hektarë tokë bujqësore, e cila përbën një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e prodhimit bujqësor. Fal kushteve të favorshme agro-klimatike dhe traditës shumëvjeçare në bujqësi, në territorin e komunës kultivohen kultura drithërore, foragjere, perime, pemë frutore, vreshta dhe kultura të tjera bujqësore.

Për vitin 2023 gjatë sezonit vjeshtor janë planifikuar gjithsej 3,065 ha, ndërsa janë realizuar 3,065 ha, që përfaqëson 100% të planifikimit.

Kultura dominuese ishte gruri me 3,000 ha, duke zënë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të mbjella. Elbi u kultivua në 10 ha, tërshëra në 50 ha, ndërsa thekra në 5 ha. Të gjitha kulturat vjeshtore u realizuan sipas planifikimit.

Për kulturat pranverore u planifikuan 1,036 ha, ndërsa u realizuan 981 ha, ose 94.7% e planifikimit.

Misri për kokërr u mboll në 400 ha, duke realizuar plotësisht planin. Misri i gjelbër u kultivua në 550 ha nga 600 ha të planifikuara, ndërsa misri me fasule u realizua në 25 ha nga 30 ha të planifikuara.

Sipërfaqet me fasule monokulturë, bimë foragjere dhe bimë industriale u realizuan plotësisht sipas planit. Në sektorin e perimeve u planifikuan 485 ha, ndërsa u realizuan 457 ha, ose 94.2% e planifikimit.

Patatja, speci, trangujt, qepa dhe pjepëri u realizuan sipas planit. Domatja u kultivua në 12 ha nga 20 ha të planifikuara, ndërsa lakra në 90 ha nga 100 ha. Sipërfaqja me shalqi arriti 50 ha nga 60 ha të planifikuara.

Perimet në serra shënuan rezultat shumë të mirë, duke tejkaluar planifikimin me 30 ha të realizuara kundrejt 25 ha të planifikuara, që tregon rritjen e interesimit të fermerëve për prodhimin në ambiente të mbrojtura. Në sektorin e pemëtarisë u planifikuan dhe u realizuan gjithsej 207 ha, duke arritur 100% të planifikimit.

Sipërfaqet përfshijnë: Mollë – 30 ha, Dardhë – 8 ha, Kumbull – 25 ha, Qershi – 15 ha, Vishnje – 20 ha, Kajsji – 2 ha, Pjeshkë – 2 ha, Arra – 100 ha dhe Lajthi – 5 ha.

Komuna e Suharekës vazhdon të jetë një nga zonat më të njohura të Kosovës për kultivimin e rrushit. Gjatë vitit 2023 sipërfaqja me vreshta ishte rreth 550 ha, të cilat përbëjnë një sektor me rëndësi të veçantë për prodhimin e rrushit dhe zhvillimin e industrisë së verës.

Edhe kultivimi i pemëve të imëta vazhdoi të zhvillohet gjatë vitit 2023. Sipërfaqet e evidentuara janë: Mjedra – 5 ha, Boronica – 5 ha, Manaferra – 1 ha, Dredhëza – 10 ha dhe Aronia – 1 ha

Gjithsej, pemët e imëta zënë 22 ha, me kulturën dominuese të dredhëzës, e ndjekur nga mjedra dhe boronica.

Për vitin 2024 sezonin vjeshtor u planifikuan 3,162 ha, ndërsa u realizuan 3,135 ha, që paraqet një realizim prej 99.1%. Gruri vazhdon të jetë kultura kryesore me 3,080 ha të realizuara, duke zënë pjesën më të madhe të sipërfaqeve të mbjella me drithëra. Elbi u kultivua në 10 ha, tërshëra në 40 ha, ndërsa thekra në 5 ha.

Për kulturat pranverore u planifikuan 1,078 ha, ndërsa u realizuan 992 ha, ose 92.0% e planifikimit. Misri për kokërr u realizua në 380 ha, ndërsa misri i gjelbër në 580 ha. Misri me fasule u mboll në 26 ha, ndërsa sipërfaqet me fasule monokulturë, bimë foragjere dhe bimë industriale mbetën pothuajse në nivelin e planifikimit.

Në sektorin e perimeve u planifikuan gjithsej 485 ha, ndërsa u realizuan 447 ha, që përfaqëson 92.2% të planifikimit. Patatja u kultivua në 70 ha, domatja në 12 ha, speci në 20 ha, trangujt në 15 ha, qepa në 60 ha, lakra në 90 ha, shalqiri në 50 ha, ndërsa pjepëri në 5 ha. Perimet në serra vazhdojnë të shënojnë zhvillim pozitiv, duke arritur 30 ha, ose 5 ha më shumë se sipërfaqja e planifikuar. Kjo dëshmon interesimin në rritje të fermerëve për prodhim intensiv dhe furnizim të tregut gjatë gjithë vitit. Perimet në fushë të hapur u realizuan në 95 ha, shumë afër planifikimit.

Pemëtaria vazhdon të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë në Komunën e Suharekës. Gjatë vitit 2024 u realizuan 207 ha me pemë frutore, duke përmbyshur plotësisht planifikimin. Sipërfaqet e kultivuara janë: Mollë – 30 ha, Dardhë – 8 ha, Kumbull – 25 ha, Qersh – 15 ha, Vishnje – 20 ha, Kajs – 2 ha, Pjeshkë – 2 ha, Arra – 100 ha dhe Lajthi – 5 ha.

Kulturat vjeshtore kanë arritur realizim në 99%, ndërsa kulturat pranverore dhe perimet janë realizuar mbi 92%. Pemëtaria dhe vreshtaria kanë ruajtur sipërfaqe të qëndrueshme, duke reflektuar interesimin e vazhdueshëm të fermerëve për këta sektorë.

Për vitin 2025 Gjatë sezonit vjeshtor u planifikuan gjithsej 3,562 ha, ndërsa u realizuan 3,157 ha, ose 88.6% e planifikimit. Gruri vazhdon të mbetet kultura më e rëndësishme bujqësore në komunë, me 3,100 ha të realizuara. Krahasuar me planifikimin prej 3,500 ha, realizimi ishte më i ulët për 400 ha, si rezultat i faktorëve ekonomikë dhe kushteve klimatike gjatë sezonit.

Elbi u kultivua në 10 ha, tërshëra në 40 ha, ndërsa thekra u realizua në 7 ha, duke tejkaluar sipërfaqen e planifikuar

Për kulturat pranverore u planifikuan gjithsej 1,090 ha, ndërsa u realizuan 1,002 ha, ose 91.9% e planifikimit.

Misri për kokërr u realizua në 380 ha, ndërsa misri i gjelbër në 580 ha. Misri me fasule u mboll në 35 ha, ndërsa fasulja monokulturë u realizua në 3 ha.

Bimët foragjere dhe bimët industriale u kultivuan në 2 ha, duke ruajtur sipërfaqe të vogla, por të qëndrueshme. Në sektorin e perimeve u planifikuan 500 ha, ndërsa u realizuan 477 ha, ose 95.4% e planifikimit.

Patatja u kultivua në 80 ha, domatja në 22 ha, speci në 25 ha, trangujt në 18 ha, qepa në 60 ha, lakra në 90 ha, shalqiri në 50 ha, ndërsa pjepëri në 7 ha.

Perimet në serra u realizuan plotësisht me 30 ha, ndërsa perimet në fushë të hapur arritën 95 ha.

Ky sektor vazhdon të tregojë zhvillim të qëndrueshëm, sidomos në prodhimin intensiv në serra, i cili po fiton gjithnjë e më shumë rëndësi. Pemëtaria mbetet një sektor i rëndësishëm i bujqësisë në Komunën e Suharekës.

Sipërfaqet e evidentuara gjatë vitit 2025 janë: Mollë – 30 ha, Dardhë – 8 ha, Kumbull – 25 ha, Qershi – 15 ha, Vishnje – 20 ha, Kajsi – 2 ha, Pjeshkë – 2 ha, Arra – 100 ha dhe Lajthi – 5 ha. Gjithsej janë evidentuar 207 ha me pemë frutore, pa ndryshime të rëndësishme krahasuar me vitin paraprak.

Vreshtaria vazhdon të jetë një nga sektorët më të zhvilluar të bujqësisë në Komunën e Suharekës.

Gjatë vitit 2025 sipërfaqja me vreshta ishte 550 ha, duke ruajtur stabilitetin e viteve të fundit. Ky sektor mbetet me rëndësi të veçantë për prodhimin e rrushit dhe zhvillimin e industrisë së verës. Kulturat vjeshtore u realizuan në 88.6%, kulturat pranverore në 91.9%, ndërsa sektori i perimeve në 95.4% të planifikimit.

Me krijimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale (ritjen e stafit të punës), planifikohet realizimi i anketimit në teren për të verifikuar dhe plotësuar informacionin ekzistues.

9. Rishqyrtimi i sasisë së përmbajtjes dhe përmasave të zbatimit të ndryshim plotësimeve, përjashtimeve dhe bonuseve të zonimit.

Vlerësojmë se përmes këtij Raporti, kemi ofruar informacione të mjaftueshme lidhur me monitorimin e nivelit të zbatimit të HZK të Komunës për periudhën e lartshënuar.

Nga viti në vit gama e informacioneve është pasuruar. Megjithatë, fokusi i trajtimit të implikimeve hapësinore të zhvillimeve sipas HZK është një aspekt kompleks për trajtim dhe ka hapësirë edhe për informacione më të detajuara për të cilat duhen analiza dhe vlerësime më të thella profesionale.

Me të dhënat e ofruara nga sektorët përgjegjës, sidomos me zhvillimet në fushën e ndërtimeve dhe zhvillimet në infrastrukturen publike, Komuna e Suharekës po përballlet me presion të shtuar ndërtimor dhe rritje të vlerës së tokës si rezultat i Planifikimeve të HZK dhe investimeve publike që ka realizuar komuna pas hyrjes në fuqi të këtij dokumenti. Kjo situatë ka krijuar nevojën për instrumente që sigurojnë balancë mes zhvillimit privat dhe interesit publik.

Duke pas parasysh që, Ligji për Planifikimin Hapësinor u jep komunave kompetenca planifikuese, por nuk përcakton qartë instrumente financiare për kapjen e vlerës së tokës si dhe Ligji për Ndërtimin rregullon procedurat dhe standardet teknike, por jo mekanizmat e kthimit të vlerës publike, Komuna e Suharekës me aprovimin e Hartës Zonale të Komunës e ka të paraparë Hartimin e Rregullores së Bonuseve për respektimin e vijës rregullative. Është formuar grupi punues cili e ka hartuar këtë rregullore sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës. Kjo rregullore edhe pse është refuzuar nga ministria nuk përbën ndalim absolut, por tregon nevojën për qasje të ristrukturuar dhe të koordinuar.

Drejtoria e Urbanizmit ka hartuar draftin e Rregullores së Bonuseve të Ndërtimit, duke marrë parasysh harmonizimin ligjor dhe kompetencat institucionale. Në vend të aplikimit të bonusit si përjashtim planifikues, qasja e rekomanduar në këtë rregullore është trajtimi i tij

si instrument ku përfitimi privat shoqërohet me kontribut të matshëm publik, si: investime në infrastrukturë, hapësira publike dhe gjelbërim, objekte me interes publik, kontributi në fonde zhvillimore urbane, etj.

Aplikimi i rregullores se bonueseve gjatë zbatimit të planit mundëson një harmonizim më të mirë të legjislacionit ekzistues që zvogëlon rrezikun e arbitraritetit dhe kontestimeve ligjore, forcon transparencën dhe interesin publik, e përdorë bonusin e ndërtimit përmes marrëveshjeve zhvillimore, jo rregullorëve të izoluar.

Statistikat finaciare për qështjet e zonimit në baza vjetore

Statistikat finaciare paraqesin një tregues të rëndësishëm për vlerësimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës ku përmes tyre është bërë pasqyrimi i ndikimit ekonomik të zhvillimit hapësinor dhe efikasitetin e zbatimit të këtij dokumenti planifikues. Të dhënat e paraqitura më poshtë janë realizuar gjatë periudhës 2023-2025, dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e aktiviteteve të ardhshme si dhe për procesin e rishikimit 4 vjeçar dhe 8 vjeçar të Hartës Zonale.

- Të hyrat e realizuara nga leshimi i lejeve ndërtimore dhe tarifave tjera që lidhen me zhvillimin hapësinor $\approx 2,005,465.95$ €
- Investimet kapitale të realizuara për projektet e planifikuara me Hartën Zonale të Komunës $\approx 11,554,766.40$ €
- Investimet kapitale të realizuara në infrastrukturë (rrugë, ujësjellës, kanalizim, ndriqim publik, hapësira publike...etj), objekteve kulturore, shëndetësore dhe sociale, që kanë mbështetur zbatimin e Hartës Zonale $\approx 10,580,952.95$ €
- Shpenzimet për hartimin, përditesimin dhe monitorimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor $\approx 349,300.0$ €

Bazuar në kapitullin Adminstrimi, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të HZK-së janë realizuar edhe projektet tjera si rezultat i analizave profesionale dhe të hollësishme me qëllim të rritjes së shërbimeve sociale, publike, infrastrukturore nga sektorët përkatës.

	2023	2024	2025
Asfalt (m²)	27,000.0	23.02	47,645.10
Kubëza (m²)	20,400.0	23.77	41,647.26
Kanalizim (m)	37,442.00	11,600.0	7,716.27
Ndriqim (m)	134,000.0	57,910.0	1,790.00
Trotuar (m²)	4,500.0	2,060.00	3,578.89
Sanim i rrugëve (m²)	66,033.00		2,402.50

Përfundime

Monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale të Komunës ka dëshmuar se HZK-ja mbetet dokumenti themelor për orientimin e zhvillimit hapësinor dhe për menaxhimin e qëndrueshëm të territorit. Gjatë periudhës së monitorimit është konstatuar se vendimmarrja në fushën e planifikimit hapësinor dhe ndërtimit është zhvilluar duke u mbështetur në përcaktimet e HZK-së, duke kontribuar në zbatim më të rregullt të politikave zhvillimore të komunës.

Rezultatet e monitorimit tregojnë se HZK ka ndikuar pozitivisht në kontrollin e zhvillimit urban, ruajtjen e strukturës funksionale të territorit, mbrojtjen e interesit publik dhe krijimin e kushteve për zhvillim të balancuar ekonomik, social dhe mjedisor. Gjithashtu, monitorimi ka mundësuar identifikimin e sfidave dhe mospërputhjeve që kërkojnë trajtim të mëtejshëm institucional.

Procesi i monitorimit ka konfirmuar rëndësinë e mbledhjes dhe analizimit të vazhdueshëm të të dhënave mbi zhvillimet në territor, pasi vetëm përmes një monitorimi sistematik mund të vlerësohet nëse objektivat e HZK-së po realizohen dhe nëse dokumenti vazhdon t'u përgjigjet nevojave reale të zhvillimit të komunës.

Rekomandime

Bazuar në rezultatet e monitorimit, rekomandohet vazhdimi i monitorimit periodik të zbatimit të HZK-së, duke siguruar mbledhjen sistematike të treguesve për zhvillimet hapësinore dhe përgatitjen e raporteve të rregullta të monitorimit.

Rekomandohet përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave hapësinore dhe digjitalizimi i informacionit planifikues, me qëllim rritjen e cilësisë së analizave dhe mbështetjen e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Është e nevojshme të forcohet koordinimi ndërmjet drejtorive komunale dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për planifikimin hapësinor, ndërtimin, infrastrukturën, mjedisin dhe kadastrën, në mënyrë që zbatimi i HZK-së të jetë sa më efektiv dhe i harmonizuar.


Rekomandohet ngritja e mëtejshme e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave në fushën e planifikimit hapësinor, monitorimit dhe përdorimit të sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).


Në rast se monitorimi i vazhdueshëm evidenton ndryshime të rëndësishme në zhvillimin ekonomik, demografik, infrastrukturor ose në kornizën ligjore, rekomandohet inicimi i procedurave për rishikimin ose ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të analizave profesionale.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të territorit, rritjen e efikasitetit të planifikimit hapësinor dhe sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm, të balancuar dhe në interes të qytetarëve të komunës.

Ekipi komunal për monitorimin e zbatimit të PZhK-së dhe HZK-së

- Visar KUÇI – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
- Armend KRASNIQI – Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
- Liridon JOLLXHIU – Drejtoria për Administratë
- Remzi BAJSELMANI – Drejtoria e Arsimit
- Gent GASHI – Drejtoria për Inspektion
- Donjeta KABASHI – Drejtoria për Kulturë, Rinë, Sport dhe Mërgatë
- Kymete BAJRAKTARI – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Erza RAMADANI – Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet
- Agim BYLYKBASHI – Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet
- Amir HOXHA – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
- Emrush BYTYQI – Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
- Doruntina BYTYQI – Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
- Atdhe BUZHALA – Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër
- Bajram SHALLA – Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
- Shega BAJRAKTARI – Drejtoria e Arsimit
- Florinda ISUFAJ – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë


.....

.....


.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....